

CURRICULUM VITAE

Rozeta Çekrezi (Biçaku), MA

Rozeta Çekrezi (Biçaku), MA është diplomuar në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan duke u specializuar në gjuhën Angleze. Pranë të njejtit universitet ka kryer studime pas-universitare për Administrim Publik dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare. Studimet Master i nivelit të I dhe të II për Didaktikën dhe Letërsinë e Gjuhës Angleze i ka kryer respektivisht në Universitetin Ca’ Foscari, Venecia Itali dhe në Universitetin Tor Vergata, Romë, Itali.

MA Rozeta Çekrezi (Biçaku) ka punuar si lektore me kohë të pjesshme në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” dhe më pas si lektore me kohë të plotë që prej katër vjetësh në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, ku aktualisht mban edhe pozicionin e Zv. Dekanes së Fakultetit të Edukimit. Pranë këtij Fakulteti ajo ka dhënë lëndë si Anglisht, Pedagogji, Histori e Pedagogjisë, Didaktikë, etj.

Fusha e përkthimit ka zënë gjithashtu një vend të konsiderueshëm në punën e saj si për shembull përkthimi nga italishtja i librit Studime Historike mbi Gjergj Kastriot Skënderbeun, nga autori Attilio Vaccaro.

Ajo merr pjesë aktive në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare dhe është në prag të fillimit të studimeve të Doktoraturës në fushën e Edukimit.